

Data 20.03.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Unite Dentare për kujdesin dentar të fëmijët”, për një periudhë 12 mujore

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

-33192400-6 (stacione pune dentare)

VLERA E FONDIT LIMIT:

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave: 16,632,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH.

Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

- sipas Kritereve të Përgjithshme të kualifikimit

Argumentimi: Shtojcë 7 është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të tre viteve të fundit financiare, ku vlera mesatare e xhiros së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 16,000,000 (gjashtëmbëdhjetë milion) Lekë, për të cilën konkuron OE.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhironja vjetore për vitet e sipërpermendura.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, të ndryshuar, në të cilën parashikohet se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës; në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rasti të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose

lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkoet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme me një vlerë jo më e vogël se 6,600,000 lekë (39.68 % e vlerës së fondit limit/Vlerës së Pritshme të Kontratës), për të cilën konkuron OE.*

- *Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", të ndryshuar, Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, piken 4 të nenit 40 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 39.68 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit/ve ose distributorit të autorizuar, për të gjithë periudhën e Marrëveshjes kuadër, për unitet dentare objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, uebsite dhe të jetë origjinal (e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe) ose fotokopje e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur mbështetur në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku është e cituar: *5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit kërkohet të paraqitet, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatorin ekonomik ofertues.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:*

- *ISO 9001: /ose/ ekuivalent, ose ISO 13 485 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/distributorin zyrtar të autorizuar nga prodhuesi, në përputhje me objektin e prokurimit (në rast kur OE ofertues nuk është prodhues duhet të dorëzojë një vetëdeklarim që furnizuesi është konform standarteve të cilësisë, AK në procesin e vlerësimit ka të drejtën e verifikimit të vetëdeklarimit. Në rast se OE shpallet fitues, duhet të paraqesë certifikatën në fjalë).*
- *Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001 për import /eksport /tregtim të materialeve mjekësore /ose/ ekuivalent brenda fushës së aktivitetit të OE, e cila përkon/përputhet me objektin e kontratës e cila po prokurohet.*

Argumenti: Ky kriter është mbështetur në pikën b) dhe c) dhe është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", ku parashikohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Gjithashtu gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.4 *Operatori duhet të paraqesë "Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore", të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore".*

Argumenti: Ky kriter vendoset duke u bazuar në nenin 77, pika 4 e Ligjit nr.162/2020"Per Prokurimin Publik", të nenit 40, pika 5, germa a), nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe në nenin 22 të Ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", i ndryshuar, ku parashikohet detyrimi që ka çdo OE që tregon pajisje mjekësore që të pajiset me Autorizimin për tregtim të pajisjeve mjekësore.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për unitet dentare objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo produkti që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Përshkrimi teknik/specifikimet teknike të kerkuara në DST duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur referuar në kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Paraqitja e katalogëve për artikujt objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përpuethshmërisë së mallit që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të cilësojë se unitet dentare objekt prokurimi të ofruara prej tij në të gjithë komponentët e kërkuar sipas DST, janë të reja dhe të papërdorura më përpara.*

Argumentimi: Këto kritere janë menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, si dhe të ketë garanci që të realizojë kontratën objekt prokurimi sipas të gjithë specifikimeve teknike. Këto kritere janë vendosur në përputhje me Nenin 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të specifikojë se merr përsipër transportin dhe dërgimin e uniteve dentare objekt prokurimi sipas përcaktimeve të bëra në pikën e DT 2.12 “Vendi I dorëzimit të objektit të kontratës”, si dhe montimin/ fiksimit / instalimin dhe testimin e funksionimit të tyre sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Këto kritere janë menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, si dhe të ketë garanci që të realizojë kontratën objekt prokurimi sipas të gjithë specifikimeve teknike. Këto kritere janë vendosur në përputhje me Nenin 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e afatit të garancisë, (minimumi 2 vjet garanci, përfshirë blerjen dhe zëvendësimin e pjesëve të dëfektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale).*

Argumentimi: Këto kritere janë menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, si dhe të ketë garanci që të realizojë kontratën objekt prokurimi sipas të gjithë specifikimeve teknike. Këto kritere janë vendosur në përputhje me Nenin 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.9 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër mirëmbajtjen e Uniteve dentare për minimalisht periudhën e garancisë, si dhe që do të përgjigjet për çdo defekt ose mos mirëfunksionim të unitit dentar.*

Argumentimi: Këto kritere janë menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, si dhe të ketë garanci që të realizojë kontratën objekt prokurimi sipas të gjithë specifikimeve teknike. Këto kritere janë vendosur në përputhje me Nenin 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.10 *Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij jo me pak se 1 (një) inxhinier: të trajnuar për montim/servis pajisjesh mjekësore dhe / ose unite dentare.*

Për të përmbushur këtë kriter, OE ofertues duhet të disponoje:

- *Diplomat përkatëse dhe CV.*
- *Kontratë pune sipas kodit të punës, e noterizuar.*
- *Çertifikata/ose dëshmi trajnimi për montim/servis pajisjesh mjekësore / unite dentare. Për të plotësuar këtë pikë, OE ofertues duhet të paraqesin si prove praprake Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8.*

Për OE që do të renditet i pari, do të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave

të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

2.3.11 *Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese.*

Argumentimi: Kriteri është vendosur në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar pasi deklarata mbi origjinën e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) është kërkuar në mënyrë që me anë të saj të bëhet krahasimi i ofertës, materialeve që ofertohen nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

2.3.12 *Në funksion të plotësimit të Shtojces 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atësi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: *Specifikimet teknike janë hartuar në varësi të objektit të kontratës përcjellë nga Grupi i punës ngritur me Urdhër Nr. 37, datë 13.03.2023.*

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standartet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT: